



KRYETARI I KOMUNËS  
MUNICIPAL PRESIDENT  
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002  
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)

DATA/DATUM/DATE	21.03.2024
01 NR/BR.	62/24
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Kryetarit të Komunës Agim Alfi
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim-Vendim për miratimin e Plotësim Ndryshimin të Rregullores 01 Nr.23 te dates 28.02.2020.

Në bazë të nenit 58 pika 1. h. të Ligjit, Nr. 03/L -040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.9, të Statutit Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50, i datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës bënë këtë:

### PROPOZIM VENDIM

Propozim vendim për plotësim-ndryshim të Rregullores 01 Nr. 23 të datës 28.02.2020 për përcaktimin rregullimit të orarit të punës dhe kujdestarive për barnatore në teritorin e Komunës së Ferizajt.

### A r s y e t i m

Me kërkesen e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizm, të cilët kanë kërkuar plotësim ndryshimin e Rregullorës me numër 02 Nr.23, të datës 28.02.2020, sipas **nenit 12.4 klasa 47.73 (barnatoret)**.

Orari i punës për barnatore do të jetë i njëjtë në dy sezone.

E hene -E shtune nga ora 08:00 deri ne ora 21:00.

Orari i kujdestarise nga ora 21:00 deri ne ora 8:00, kujdestarojne 3 barnatore.

Orari i kujdestarisë për barnatore , të dielave dhe gjatë festave zyrtare fillon nga ora 08:00 deri në ora 08:00, kujdestarojnë 5 (pesë) barnatore.

Orari i kujdestarisë do të përgatitet nga grupi punuese, në bashkëpunim me njëra tjetrën, për periudhën 6 (gjashtë) mujore nga dita e miratimit të kësaj rregullore, i cili orar do të ripërtërihet çdo 6 (gjashtë) muaj dhe do të sjellet për miratim në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.

Orari i kujdestarisë duhet të publikohet nga barnatoret dhe institucionet e kujdesit parësor shëndetësor

Kërkojmë nga Kuvendi i Komunës të miratoj propozim-vendimin për plotësim ndryshimin e Rregullores 01 NR.23 të datës 28.02.2020.